

Deklaratë e përbashkët e Presidentëve të CCEE-së dhe të CEC-it me rastin e Kohës së Krijimit 2020

Të krishterët e gjithë botës prej datës 1 shtator deri me datën 4 tetor kremtojnë Kohën e Krijimit dhe më 1 shtator kremtojnë Ditën e Krijimit. Edhe këtë vit, si vitet e kaluara, CCEE-ja dhe CEC-i përfitojnë prej këtij rasti që t'i nxisin besimtarët të Kishave në Evropë për t'i parë këto ditë si një rast për të kremtuar pasurinë e fesë sonë.

Koha e Krijimit zë fill që prej rrënjëve të fesë së krishterë. Krijimi është një dhuratë e Hyjit për njerëzimin dhe për të gjitha qeniet e gjalla, pra është përgjegjësia jonë që ta ruajmë atë si mbarështues të mirë e të besueshëm dhe si shërbëtorë besnikë të Hyjit. *“E Zotit është toka dhe gjithçka ajo ka, rruzulli mbarë e të gjithë banorët e tij”* (Ps 24, 1).

Papa Francesco në enciklikën e tij *Laudato Si' (Ti Qofsh Lëvduar)*, ka theksuar se *“sfida urgjente për ta mbrojtur shtëpinë tonë të përbashkët përfshin shqetësimin për ta bashkuar krejt familjen njerëzore në kërkim të një zhvillimi të qëndrueshëm dhe tërësor”*. Në të njëjtën kohë, ka bërë një apel të fortë *“për ta ripërtërirë dialogun mbi mënyrën me të cilën jemi duke e ndërtuar të ardhmen e planetit tonë. Kemi nevojë për një ballafaqim që na bashkon të gjithëve, pasi sfida mjedisore që jetojmë dhe rrënjët e saj njerëzore, kanë lidhje me ne dhe na prekin të gjithëve”*.

Në të njëjtën mënyrë njëri prej teologëve më të mëdhenj të epokës sonë, Juergen Moltmann, ka deklaruar se *“sot kundërshtari teologjik është nikilizmi i praktikuar në marrëdhëniet tona me natyrën”* dhe ka kërkuar *“një shohitje mbi Hyjin që është i pranishëm në krijim nëpërmjet Shpirtit Shenjt të Tij”*, një shohitje që *“mund t'i çojë burrat dhe gratë në pajtim dhe paqe me natyrën”*.

Kremtimi i Ditës së Krijimit dhe Koha e Krijimit ka një përmasë ekumenike domethënëse. Duke kremtuar këto ditë le të shikojmë prapa në shenjë falënderimi ndaj propozimit të të ndjerit Patriark ekumenik Dimitrios I bërë në vitin 1989. Që atëherë, ideja e Kohës së Krijimit dhe shpirti i tij ekumenik janë konfirmuar edhe më shumë në Asambletë Ekumenike Evropiane të organizuara së bashku prej CCEE-së dhe CEC-së, prej Bazilesë (1989) nëpërmjet Gracit (1997) deri në Sibiu (2007).

Këtë vit, pandemia COVID-19 ka zbuluar se sa thellësisht e ndërlydhur është bota në të cilën jetojmë. Më shumë se kurrë kemi kuptuar se nuk jemi ishuj për njëri-tjetrin dhe se kushtet për shëndetin e mirëqenien njerëzore janë të brishta. Ndikimet e pandemisë na detyrojnë që ta marrim seriozisht nevojën për një vigjilencë më të madhe dhe për kushte jete të qëndrueshme në mbarë tokën. Kjo gjë bëhet edhe më e rëndësishme nëse marrim parasysh shkatërrimin mjedisor dhe kërcënimin e ndryshimit klimatik.

Ju ftojme që ta kremtoni këtë vit Kohën e Krijimit nën titullin e Jubileut për tokën. Koncepti i Jubileut është i rrënjësuar në Bibël dhe thekson se duhet të ekzistojë një ekuilibër i drejtë dhe i qëndrueshëm mes realitetit shoqëror, atij ekonomik dhe ekologjik. Mësimi i jubileut biblik na tregon nevojën për t'i riekulibruar sistemet e jetës, pohon nevojën e barazisë, të drejtësisë dhe të qëndrueshmërisë, pohon gjithashtu nevojën për një zë profetik në mbrojtje të shtëpisë së njeriut.

I ftojme të gjithë Barinjtë dhe të krishterët evropianë, famullitë, bashkësitë kishtare dhe çdo person vullnetmirë, që t'i kushtojnë vëmendje Kohës së Krijimit për ta jetuar atë me shpirt ekumenik, të bashkuar në lutje dhe veprim.

I Nderuari Christian Krieger

Hirësia e Tij Kard. Angelo Bagnasco

President i CEC-it

President i CCEE-së